



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 21

Datë: 22. 02. 2021. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjes nr,15, 16 dhe 17/2021**
- 3. Aktivitetet e SKQZ-së**

-Raporti nga QNR

4.Aktivitetet e ZRPP-së

–Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për regjistrim të partisë politike “Pokret za Župu i Dijasporu – ŽUPSKA”

5.Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

Valdete Daka: Përshëndetje të gjithëve. E hapim mbledhjen e 21-it të KQZ-ës, më rendin e ditës si në propozim që e kemi. A ka dikush vërejtje? Nëse jo, kush është për këtë rend dite? Faleminderit, fillojmë më procesverbalet e mbledhjes 15,16 dhe 17. A kemi vërejtje në këto procesverbale?

Sami Kurteshi: Për mua këto procesverbale janë tepër të vonshme, unë jam deklaruar njëherë dhe po deklaro hem përsëri që vetëm procesverbalet e mbledhjes së kaluar mund të i shqyrtoj përndryshe asnjë procesverbal tjetër, kjo është e pa toleruar dhe e pa lejuar se çfarë po behet këtu më këto procesverbale.

Valdete Daka: Kush është për miratimin e këtyre procesverbaleve? Kush është kundër? Vazhdojmë me aktivitete e SKQZ-ës, raportin nga QNR-ja.

2.Aktivitetet e SKQZ-së

Raporti nga QNR

Burim Ahmetaj: QNR-ja, deri më tani po thujse i ka përfunduar të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë më procesimin e materialeve zgjedhore, pra është fjala për materialet të cilat janë procesuar në mënyrë të rregullt po ashtu krahas kësaj është bërë edhe regjistrimi i të gjithë votuesve më kusht në bazën e të dhënave dhe aktivitet tjetër që është duke u zhvilluar në QNR, është skanimi i formularëve të rezultateve që kanë mbetur edhe 2 komuna të cila janë në proces e sipër dhe do të publikohen të gjitha formularët e krijuar në vendvotim në ueb-faqen e KQZ-ës, dhe aktivitet tjetër i është duke u zhvilluar është aktiviteti i shërbimit votues për vlerësimin e pakove të supozuara më fletëvotime. Nga shërbimi votues deri me tani kemi nga 19.168 pako të vlerësuara, nëse 44% të pakove janë të vlerësuara deri me tani, janë të aprovuar 22. 326 zarfe, të refuzuara janë pjesa tjetër, gjithsej të procesuara janë 31.375 zarfe nga 19.168 pako apo 44% të pakove të procesuara deri më tani. Ndërsa sa i përket procesimit të materialeve të zgjedhjeve, konkretisht formularëve të zgjedhjeve, formularëve të përputhjes së të dhënave dhe rezultateve dhe formularëve të rezultateve të kandidatëve, QNR-ja po thujse i ka procesuar të gjithë formularët dhe të gjithë ata formular që nuk kanë pasur probleme teknike, të gjithë janë procesuar në rregull vetëm një numër i vendvotimeve konkretisht formularëve të rezultateve të kandidatëve të cilët nuk kanë mundur të procesion si të rregullta dhe kanë dështuar për arsye të ndryshme, kanë dështuar të kalojnë edhe auditimin. Të gjithë

formularët e rezultateve i janë nënshtruar procesimit të dyfishtë në bazën e të dhënave dhe një numër i madh i formularëve të rezultateve, faktikisht formularëve të rezultateve të kandidatëve po thuajse shumë pak kemi probleme me formularët e rezultateve për subjekte, mirëpo problemet më të madhja janë për formular të rezultateve të kandidatëve dhe nuk kanë mundur të procesohen si të rregullta për shkaqe të mospërputhjes së votave të subjekteve dhe kandidatëve. Nga auditimi i formularëve të rezultateve procedurë e brendshëm e QNR, në bazë të gjeturave është bërë klasifikimi i mospërputhjeve të formularëve të rezultateve, të gjitha të gjeturat i kemi grupuar në 4 grupe, grupi parë ka të bëjë me bartjen e gabimin e votave në formular të përputhjes së të dhënave dhe rezultateve dhe janë 35 vendvotime të cilët nuk kanë mundur të kalojnë auditimin , një numër i vendvotimeve nuk kanë mundur të procesohen si të rregullta të cilat nuk kanë mundur të kalojnë për arsye se formularët e përputhjes së të dhënave dhe rezultateve janë bartur votat gabimisht tek subjektet tjera, kjo është arsyeja të grupi i parë i vendvotimeve që janë në tabelën e rekomandimit për rinumërim, ka të bëjë me formularët e përputhjes së të dhënave dhe rezultateve, pra gabim në bartje të votave FPR. Kategoria e dytë është gabim në bartjen e votave në formular të rezultateve të kandidatëve pra nga të gjeturat rezulton se janë 6 vendvotime me probleme teknike në gjendjen si janë nuk mundet të procesohen në bazën e të dhënave për shkak se votat janë të paqarta, nuk janë të shënuara në mënyrë të qartësuar votat për kandidat. Kategoria e 3-të që ka numrin më të madh të vendvotimit për të cilat rekomandohet që të kemi rinumërim për to është kategoria kur kandidati ka më shumë vota apo të gjithë kandidatet kanë më shumë vota se sa subjekti, nga të gjeturat nga auditimi rezulton se janë 370 vendvotime në të cilat një kandidat ka më shumë vota sesa subjekti dhe në raste të caktuar kemi të gjithë kandidatet kur kanë vota më shumë sesa subjekti, edhe për këtë është rekomandimi që të kemi rinumërim të plot i keni në tabelë të gjitha sipas rekomandimeve. Dhe kategoria 4-ër është kur subjekti ka vota ndërsa kandidatet nuk kanë vota dhe anasjellas, nga të gjeturat nga auditimi rezulton se behet fjalë për 83 vendvotime, tek të cilat nuk ka vota tek subjekti ndërsa kandidatet kanë vota dhe anasjelltas kur kandidatet nuk kanë vota ndërsa subjekti ka vota, pra të gjitha këto probleme të cilat nuk kanë mundur të procesohen të rregullta sistemi i ka detektuar dhe aktualisht në formën si janë nuk mund të procesohen si të rregullta dhe për këtë arsye i kemi 4 rekomandime të cilët i kemi sjellë para KQZ-ës dhe nevojitet vendimmarrje në mënyrë që të procesohet më tutje këto formular të rezultateve.

Vlen të theksohet se, nuk kemi probleme me votat të subjekteve mirëpo problemi kryesisht është të votat e kandidatëve dhe mos shënimi i sakët i votave të kandidatëve. Sistemi ka deduktuar të gjitha këto vendvotime dhe behet fjalë për 494 vendvotime të cila nevojiten të rinumërohen apo në %, 20.74% prej totalit të vendvotimeve. Kaq sa i përket raportit i keni të detajuar në mënyrë tabelore dhe në detaje për secilën vendvotim se çfarë problemi ka pasur gjatë auditimit nga të dhënat të cilat

janë në të gjithë formularët e rezultateve dhe për këtë nevojiten vendimmarrje e KQZ-ës, në mënyrë që të procesoim më tutje.

Valdete Daka: A ka dikush pyetje për Burimin?

Sami Kurteshi: Unë kam disa çështje disa pyetje, po e fillojë më procedimin e votave nga jashtë, ne jemi duke i përcjellë vazhdimisht të gjithë procedurën në QNR që 5 ditë dhe kemi vërejtje që dua ti them këtu: 1. Procedimi i votave nga jashtë e përdor një gjuhë për ato vota që nuk ka mundur të verifikohen apo në çfarë do mënyrë nuk janë aprovuar si të refuzuara, ato nuk janë të refuzuara ato vota duhet të verifikohen edhe njëherë secila veç e veç se cilat janë arsyet dhe për këtë KQZ-ja duhet që të merr një vendim për krijimin e një komisionit kompetent përgjegjës që verifikon secilën aplikim, cilat janë arsyet këtu kemi disa arsye D1,D2,D3,D4,D5,D6 dhe nuk është D7 unë e kam pa edhe një kuti më D7, mirë është të sqarohet se çfarë do të thotë ajo dhe këto sqarime këtu nuk janë të mjaftueshme, ka raste kur personat kanë aplikuar dhe dalin sikur nuk kanë aplikuar, ka raste kur aplikacioni është refuzuar po në të vërtet nuk është refuzuar, kjo është një çështje e cila len mjaft dilema dhe shtron shumë pyetje. Ne e dimë nga fillimi deri në fund se çështja e votave nga jashtë është përcjellë më probleme më të mëdha, në të gjitha proceset të procedurës KQZ-ja në të vërtet nuk ka arritur të përmbush obligimet e veta sa i përket votave nga jashtë kjo është pasoj e mos aplikimit të një aplikacionit online ku janë krijuar qindra fish shpenzime ma të mëdha, ngarkesa me të mëdha dhe nuk ka mundur më i përmbushur obligimet, KQZ-ja ka shkelur afatet dhe tani vjen të fjala refuzim nuk mundën të refuzohen qytetaret e Republikës së Kosovës që dëshmojnë që janë qytetar të Republikës së Kosovës, kanë aplikuar dhe kanë të drejt kushtetuese të garantuar mund të ketë shkelje ose mund të ketë çështje të vogla por këto s'munden të refuzohen, prandaj kërkesa është që të krijohet një komision edhe sigurisht një numër shumë i madh nga këto që po i shoh unë këtu prej 9000 gjithsej të refuzuara, këtu duhet të verifikohet secila votë veç e veç dhe secilin aplikacion veç e veç KQZ-ja.

Unë mendoj se, tash jemi duke i shkelur afatet, kjo është duke shkuar shumë ngadalë ju vetë deklarat se është dikur nën 50% të hapjes së plikove, nuk janë angazhuar të gjitha kapacitete po edhe sikur të angazhoheshin të gjitha kapacitete nuk do të mundeshin të arrin sepse ne kemi bërë shkeljen e parë i gjithë procesi i numërimit dhe rinumërimi të votave është elektronik nuk kemi mundur të dalim jashtë kësaj, kurse kur ka qenë fjala të aplikimi elektronik i votuesve nga jashtë kemi than kjo nuk benë sepse e prish integritetin e procesit kjo është absurde që e kemi marr ne vendim, por di do qoftë secila votë që quhet e refuzuar edhe nuk është e refuzuar duhet të verifikohet edhe njëherë dhe ne nuk kemi të drejt askujt të ja mohojmë për çfarëdo arsyeje të drejtën e votës, nëse ai votues apo ajo votuese e ka kryer obligimin e vet, këtu nuk është kryer një obligim nuk është publikuar lista e të gjithë aplikuesve

me e pa secili që a është në atë listë dhe me u ankuar nëse nuk është në atë listë, por ka sic duket raste kur njerëzit kanë aplikuar dhe ju thua që nuk keni aplikuar sepse më gjasë kanë humbur email-at apo nuk janë hapur të gjitha dhe duhet të publikohet lista e atyre që janë refuzuar, kurrë nuk është publikuar nuk mundesh me i than dikujt nuk kë aplikuar ose nuk i ke plotësuar kushtet pa e treguar listën e të refuzuarve. Çështja e 2-të është të auditimi i vendvotimeve, auditimi ka filluar të mërkurën më gjasë të premtën nga ajo që unë e kam pa kanë qenë mbi 175 vendvotime të audituara që kanë qenë të rekomanduara për rinumërim, nga e premtja salla në QNR, nuk futen vendvotimet për rinumërim, pse kjo zvarritje ka mundur të premtën, të shtunën, të dielën më u bë rinumërimi dhe sot kishin mbetur 100 kutia e fundit, ne sot e fillojmë për 4 ditë e shtyjmë rinumërimin pa asnjë nevojë sepse ato kanë qenë të rekomanduara nga auditimi, ne nuk kemi marr vendim për arsyeje se nuk kemi mbajtur mbledhje. Tani në lidhje më votat nga jashtë, ka informata dhe neve nuk na janë përcjellur ato informata se ka ardhur post e shpejt në DHQ dhe në posten e rregullt ka disa pako se sa janë ne nuk i dimë, po ne nuk jemi të informuar si KQZ, nëse ka pako që kanë ardhur në emër të KQZ-ës, pronar i atyre pakove është KQZ-ja dhe ato duhet që të i tërhiq, a numërohen apo nuk numërohen ajo ka me qenë çështje e një vendimi gjyqësor por jo të heshtet. A ka pako që presin në posten e shpejt DHQ apo posta të tjera apo nuk ka? Nëse ka pse nuk janë tërhequr ato, aty ka edhe dokumente personale nuk është posta pronare e atyre plikove por është KQZ-ja, e pastaj njerëzve ju hapet rruga apo subjekteve që për to të kërkojnë shfrytëzimin e mjeteve ligjore por jo vetëm të heshtet. Pse nuk është informuar KQZ-ja?

Ne, kemi marr informatë jashtë KQZ-ës, se aty ka vota, ato duhet të pranohen më çdo kusht. Çështja tjetër që nga bisedat aty janë votat me kusht, votat me kusht tani janë përfunduar, janë numëruar, janë krahasuar me listat e votuesve. Pse për to nuk merret vendim më u numëruar? Ato duhet të numërohen, cila është arsyeja me pritë, QNR-ja është për numërimin, rinumërimin dhe nxjerrjen e rezultateve të votimeve dhe nuk është që të pushojë, unë që 3 ditë personalisht e shoh që pushojnë tavolina e numërimit nuk ka asnjë arsyeje të vetme ose ka ndonjë arsyeje madhore që ne nuk po e dimë. Dhe një çështje tjetër ne e kemi pa aty policin dhe prokurorin që kanë bërë hetimin lidhur me një numër të votave nga jashtë nga policet dhe prokurori, unë jam informuar personalisht se ka një vendim të gjykatës për hetime, vendimin e gjykatës ne nuk e kemi, thotë po e ka KQZ-ja. Kush e ka atë vendim? Pse ai vendim nuk ju dërgohet anëtarëve të KQZ-ës? Titullari i KQZ-ës është KQZ-ja anëtarët e KQZ-ës, pse po fshihet ajo, ka hetim prokuroria ka marr vendim që ta hetoj një numër të caktuar të votave dhe ne nuk dimë asgjë. Pse unë nuk e kam atë vendim? Dhe çështja e fundit ne nuk kemi guxim që të lajm tema tabu në mjetet e informimit po edhe nga vendvotimet shihet se ka pasur keqpërdorime dhe manipulime të votave për partitë e komuniteteve, ka raste kur ne disa komuna dhe vendbanime ku nuk ka sidomos minoriteti boshnjak, ku nuk ka pjesëtar të minoritetit boshnjak, partitë

boshnjake kanë marr vota jashtëzakonisht shumë ose edhe një parti rome në Graçanic, ajo po diskutohet në publik behet e madhe ka supozime të ndryshme ndërsa KQZ-ja hesht. Unë e di që Kosova është një zonë zgjedhore dhe kush do ka të drejtë më votua kë do, mirëpo votat për vendet e garantuara nuk mund të keqpërdoren nga komunitete shumicë sepse atëherë i bije që shqiptaret kanë shumë vota i ndaj nja 100.000 vota për këto komunitete pakicë, për disa nga partitë që dojnë dhe mandej i marrim në kuvend, jo ato vota janë të parapara për pjesëtarët e komuniteteve shumicë që të nxjerrin përfaqësuesit e tyre nga kutit e votimit në kuvendin e Kosovës dhe në institucione tjera këto janë çështje që ne duhet të i diskutojmë, unë e kam ngritur edhe çështjen D6 qenka të votuesve jashtë vendit të atyre që kanë dërguar dokumente jo valide, dhe unë po them përsëri se a janë valide ato me afat të skaduar, ne e kemi marr një vendim që të votohet me dokumente të vlefshme por që nuk kanë afat për arsyeje madhore nga vetë shteti i ka krijuar, nuk ka dhen dokumente të tilla që ato të lejohen dhe dikush ka dhen urdhër që këto pliko më vota të refuzohen nga votuesit jashtë vendit, këto janë çështjet që unë po i ngriti dhe unë kisha dashtë me i dëgjuar përgjigjet për këto çështje por edhe KQZ-ja më marr vendim, ne nuk kemi pas mbledhje dhe nuk kam pasur mundësi me i ngrit këto çështje, po të mbanim mbledhje rregullisht natyrisht që o i kisha ngritur vazhdimisht.

Burim Ahmetaj: E para kisha pasur qejf që nga KQZ-ja mos të bëjnë trysni e as presion në pjesët operacionale sa i përket procesimit.

Sami Kurteshi: Kjo fjali është për mbulimin e mos punës dhe mos organizimit të mirë atje. Unë bëra pyetje dhe nuk behet kurrfarë presioni, e drejtë e anëtareve të KQZ-ës është më qenë të kohen në vëzhgimin e procesit të numërimit dhe rinumërimit, leni këto forma të presionit ju sa doni mundeni më than mos bëni presion, kjo formë është e palejueshme. Asnjë presion nuk ka unë po bej pyetje konkrete pse nuk behën veprime të caktuara në QNR dhe leni këto forma jo po bëni presion. Unë po dua përgjigje konkrete në pyetjet që i shtrova dhe ishin konkrete.

Burim Ahmetaj: KQZ-ja ka miratuar një plan operacional për qendrën e numërimit dhe shërbimin votues nuk ka asnjë afat të përcaktuar ligjor se kur mundet të përfundoj. Ne jemi në proces dhe hera e parë është që QNR-ja i ka plotësuar më herët se sa të gjitha vitet zgjedhore i ka procesuar materialet dhe tani jemi në pritje të materialeve praktikisht, për vlerësimin e pakove nga shërbimi votues se të gjitha aktivitete janë në QNR janë përfunduar jemi në pritje edhe të 494 vendvotimeve të cilat do të rinumërohen dhe nuk qëndron që QNR-ja rrinë kot ku aty janë procesuar të gjitha në bazë të proceduarave janë procesuar me kohë dhe nuk kemi shkelje as afatit e as kohës, ajo që është më e rëndësishme sa i përket votave më kusht që e potencuat pse nuk fillon numërimi i votave më kusht sepse do të na duhet më prit të regjistrohen edhe të gjitha votat me post sepse kemi votues që kanë votuar edhe më post dhe ka ardhur edhe të votoj ditën e zgjedhjeve , kemi votues më kusht që ka

votuar dhe i rregullt në ditën e zgjedhjeve dhe të gjitha këto kontrolle do të behën pastaj do të del raporti i verifikimit dhe të gjithë votuesit kanë votuar ma shumë së njëherë vota e tyre do të refuzohet, kjo është procedurë dhe procedurën e kisha pas qejf mos me ndërhy askush. Sa i përket votave të aprovuara po ashtu është procedurë që KQZ-ja e ka miratuar, janë këto procedurat që shërbimi votues i ka për secilën kategori të refuzuarit dhe po ashtu unë nuk shoh arsyeje pse më ndërhy në procedurë kur janë kriteret e qarta të cilat KQZ-ja i ka miratuar. Sekretariati nuk miraton asnjë procedurë është KQZ-ja ajo e cila ka miratuar në bazë të kriterëve dhe në krejt çfarë jemi duke punuar jemi duke punuar në bazë të kriterëve dhe asgjë me tepër, që përfshin edhe listën e të refuzuarve. Për të gjitha këto mund të them që sekretariati është duke punuar në bazë të procedurave ndërsa sa i përket dokumenteve valide, vendimi i KQZ-ës nëse jam unë i qartë ose me permisoni nëse kam gabim, ka pasur të bej më ditën e votimit ne ditën e zgjedhjeve që ju lejohet votuesve që të votojnë më dokumente jo valide. Mirëpo sa i përket punës në QNR është i përfunduar me kohë, të gjitha procedurat janë të përfunduara me kohë deri të shtunën pasdite është punuar, kurse të dielën i kemi kontrollet që i kemi të zakonshme dhe asgjë nuk mundemi më bë jashtë kontrolleve, kështu që që i procesoim materialet do të na duhet dhe të e kontrollojmë sepse bahet fjalë për mbi 2300 vendvotime të cilat kanë artikuj të ndryshme, janë formularët e rezultateve për subjekte, formularët e rezultateve të kandidatëve, janë votat më kusht, janë listat përfundimtare të votuesve, libri i votimit pastaj janë edhe votat më post dhe të gjitha këto artikuj në sistem nuk mund të plotësohen vëmë më një klik, mirëpo do të na duhet edhe kohë, sigurisht që këtu është edhe KQZ-ja të cilët kanë qenë edhe vite më herët dhe është hera e parë që sekretariati apo QNR-ja i ka procesuar shumë më herët krahasuar më vitet e kaluara....

Sami Kurteshi: Votat me kusht dhe votuesit më kusht a janë nga lista e votuesve në Kosovë apo në mërgatë? Nga ajo që unë kam kuptuar dje verifikimi i listës së votuesve më kusht është kontrolluar, është verifikuar... edhe pyetja ime ka qenë direktet për ta, a është kjo listë e votuesve nga jashtë apo brenda Kosovës. Pse duhet të pritet përfundimi i votave nga jashtë që të numërohen votat më kusht? Nëse ajo nuk qenka pjesë e listës së votuesve nga jashtë, kjo është çështja konkrete kurse në qendrën për futjen të dhënave, ata than që ne e kemi bërë këtë verifikim, unë e kam edhe raportin vetëm dikush këtu nuk qenka duke i dhen të dhënat si duhet.

Sami Hamiti: Duhet të shikohet së procedurat, se as procedurat dhe as votat me kusht, as votat jashtë vendit nuk mund të numërohen pa përfunduar këto që janë brenda dhe të skenohet lista votues komplet që të behën krahasimet, proceduralisht duhet të pritet, është e vërtet që ato votat me kusht janë individualizua dhe janë të regjistruara diku por krahasimet nuk janë bërë, sa e kam marr unë raportin dhe e kam krahasuar. Realisht mund të behet ajo çfarë po thotë z. Kurteshi në suaza që çdo herë mund të perfeksionohen edhe më shumë por krahasimesh më procedurat e zgjedhjeve të tjera,

unë e shoh që është një trend normal i procedimit të këtyre të dhënave dhe nuk po shoqë është duke shkuar diçka e cila është duke u keqpërdorur apo duke u stërzgatur por është një procedur normale duke shkuar. Ato janë gjendje faktike që kanë ndodhur sepse nuk e ka bërë as KQZ-ja e as QNR-ja që të shkojnë 494 kuti në rinumërim, është çështje e subjekteve tona politike të cilave ditën e votimit ja u dorëzojmë procesin dhe janë komisionarët të gjitha partive të cilat realisht kanë dështuar që të i plotesojnë formularët si duhet. Të gjitha i kanë pasur formularët po, trajnimet i kanë pasur dhe po shohim që 80% i kanë procedurën mirë, 80% i kutive janë proceduar dhe janë në rregull, 20% kanë dështuar trupat zgjedhore të cilat nuk janë i delegojnë subjektet politike. Tani jemi në një situatë të cilën janë këto kuti duhet të rinumërohen ndërsa pjesën tjetër të procedimi i votave të cilat vinë nga diaspora është proces që sigurisht kërkon pak më shumë kohë, unë e shoh si procedur a mund të rritet stafi atje, por rregulla të reja nuk mundim të vendosim për ato vota sepse ato i kemi vendosur në KQZ.

Tani, po flasim për një dokument valid apo jovalid, ne kemi refuzuar për dokument jo valid sepse është vendim i KQZ-ës, vendimin atë ditë e kemi marr për votuesit brenda vendit që të shkojnë në vendvotim dhe shihet që është personi i caktuar dhe e kemi ditur edhe atë ditë që po bëjnë lëshime sepse me ligj është saktë e caktuar që nuk mund të votosh, tani në procedurën të cilën ne vetë e kemi vendosur, në procedurën e aplikimit normalisht që njerëzit që nuk kanë dorëzuar edhe një dokument shtesë të vendit sepse e kanë pasur atë të drejtë, të vendit prej nga e qojnë votën nëse ka pasur një dokument valid ai nuk është refuzuar e ka dërguar dokumentin valid shtetit ku është dhe ju ka pranuar. Në këtë rast tani bënë diskriminim se në rastin e parë ata njerëz janë refuzuar sepse nuk kanë dorëzuar dokument tjetër valid, dhe tani nuk mundesh të besh komisione mbi komisione dhe të shkojmë në pafundësi të këtyre. Rregullat i kemi vendosur vetë dhe shërbimi votues shkon sipas atyre rregullave dhe nuk kemi çfarë të ndërhyrë ne në proces tutje. Prandaj nuk shoh që duhet të bëjmë trysni të madhe sepse ato janë procedura, unë besoj që me tavolinat që janë atje dhe stafi që është atje unë besoj që do të përfundoj ky rinumërim për 3 ditë.

Arianit Elshani: Sa i përket punës në QNR, unë i shikova edhe datat të vitit 2014, zgjedhjet e jashtëzakonshme të 2014,2017, 2019 në secilën nga këto zgjedhjet procesi deri në shpalljen e rezultateve ka zgjatur 2014 dhe 2017, 18 ditë ndërsa në 2019 ka zgjatur 32 ditë dhe për ato probleme të krijuara po e dimë se çfarë ka ngjarë në zgjedhjet e 6 tetorit, pastaj nderi në certifikim dukshëm janë ditë më shumë 27,28 ditë për zgjedhjet e 2019. Më punën që po e shoh që po zhvillohet në QNR dhe me ato këtu në KQZ po e shohë një punë të jashtë zakonshme që po behet, këto që nuk kanë punuar prej të premtes realisht po thujse jam çdo ditë prezent në QNR dhe kam pa që procesi i votave më kusht ka përfunduar të shtunën, pra të shtunën në mbrëmje ka përfunduar regjistrimi i votuesve më kusht. Një pyetje që e beri z. Kurteshi lidhur më pse nuk fillon numërimi i votave më kusht, mendojë që ata që e njohin operacionisht këtë punë, realisht duhet të ndërtohen 3 shtresa te listës

së votuesve, shtresa e parë i listës votuese të Kosovës, shtresa e dytë i listës votuese të atyre që kanë votuar më kusht dhe me pas shtresa tjetër i cili është i atyre që regjistrohen nga votimi nga jashtë, pastaj e gjitha kjo ju nënshtrohet një lloj verifikimi se cilët persona kanë votuar 2herë, 3 herë apo ndoshta kanë votuar vetëm njëherë nga një vendvotim qoftë ai me kusht apo në vendvotim të rregullt apo nga diaspora, kështu që proceduralisht e shoh në rregull si proces për shkaqe të verifikimit. Po mendoj që nuk ka edhe shumë ditë deri në shpallje të rezultateve me aq sa kam pa punën edhe të shërbimit votues po mendoj brenda kësaj jave ndoshta përfundon ai proces i regjistrimit dhe pastaj fillojnë edhe me procesin e numërimit të votave të diasporës. Sa i përket numrave dhe shifrave të aplikacioneve dokumenteve jo valide për sqarim të opinionit publik është numër shumë i vogël i atyre që janë më dokumente jo valide, numri më i madh i personave është të atyre që nuk kanë aplikuar fare për regjistrim për votim, pra kemi 3824 persona të cilët nuk kanë aplikuar fare për të votuar nga jashtë, nuk kanë dërguar as dokumente, as email, pra në KQZ pavarësisht që kanë qenë 3 adresa që kanë qenë të hapura asnjë dokumentacion nuk e kanë dërguar për me u regjistruar si votues nga jashtë, këtu qëndron numri më i madh jo i atyre me dokumente jo valide unë edhe njëherë kërkoj sqarim edhe nga sekretariati sepse kjo jo valide i ka disa kuptime, kuptimi i parë është skadimi i datës, tjetra është që është dokument nuk mund të identifikohet pra nuk është dokument valid, nuk është pasaporta, apo letërnjoftim apo nuk është patën shofer, pra kërkoj sqarime, për këtë ndoshta mundet Besniku me na i dhen sqarimet për shërbimin votues, kriterin e kësaj pike.

Tjetra: atë që e përmenden edhe parafolësit lidhur me auditimin formularëve të rezultateve vërehet që problemi ka qenë tek trupat zgjedhore, të komisioneret në vendvotime, të cilët nuk kanë arritur qoftë me tendencë qoftë pa te nuk kanë shfaqur mirë rezultatet në formularët e rezultateve të kandidatëve apo subjekteve politike dhe realisht është shifër e ngjashme më atë së çfarë pash unë 2014 dhe 2017, pra 205 po ashtu kanë qenë më vendime të PZAP-ës dhe vendimet e KQZ-ës kanë qenë që të shkojnë në rinumërim, pra është shifër e njëjtë më zgjedhjet e kaluara, përveç të 2019 që ka shkuar në 80% të formularëve, kështu që unë pres që të vazhdojmë më aprovimin e këtyre rekomandimeve dhe të i hapet rrugë sa më shpejt rinumërimit të rezultateve kryesisht të FRK-ve edhe pse rinumërimi do të jetë i plotë, mirëpo realisht sa i përket subjekteve nuk është që mund të ndryshoj diçka.

Sami Kurteshi: Tani unë e kam këtu përpara një tabelë që na ka dërguar për mbledhjen, është përmbledhja e votave më kusht, dhe këtu janë 31.486 numri i fundit dhe thotë është bërë rishikimi është bërë auditmi krejt është 00, rishikimi është krejt 00, në karantinë nuk është asnjë në bazë të tabelës që na i keni dërguar ju, të kryera janë 100%, të anuluar nuk ka, do të thotë që të gjitha votat më kusht në bazë të asaj që unë e dëgjova mbrëmë dhe në bazë të kësaj tabele janë të kryera, të

krahasuara me listat e votuesve në Kosovë, nëse ju qëndroni pas kësaj tablele sikur se si qëndron edhe QNR-ja.

Burim Ahmetaj: Të gjitha ato që i potencuat janë rrjedha e punës deri në finalizimin e tyre sepse të gjithë zarfet e fletëvotimeve më kusht që regjistrohen për herë të parë, regjistrohen për herë të dytë mund të kenë mos përputhje mes vetë, duhet të shkojnë në rishikim, i rishikojmë krahasohen dhe në fund të gjitha ato të cilat janë pranuar si zarfe që ju kanë nënshtruar procesit të regjistrimit e deri në përfundim nënkupton ajo është rrjedha e punës pjesa e brendshme dhe të cilat te gjitha duhet të përfundojnë 100% qe duhet të kompletohen edhe është shifra e saktë, pra vota me kusht janë 31.486 zarfe të regjistruara në sistem pra ky është hapi që është bërë regjistrimi i tyre dhe e kemi saktësinë e të gjitha zarfeve të regjistruar në sistem, pra ajo çfarë theksuat ju është rrjedha e punës brenda sistemit në QNR.

Valdete Daka: A duhen edhe votat nga jashtë të krahasohen më këto votat me kusht?

Burim Ahmetaj: Gjithmonë i kemi krahasuar votuesit e rregullt, votuesit me kusht dhe votuesit jashtë vendit krahasohen sepse një votues më kusht ose një jashtë vendit mund të e shfrytëzoj të drejtën më votua ose me kusht ose jashtë vendit.

Valdete Daka: Pra për ta sqaruar më qartë dikush që ka votuar me kusht mundet më qenë edhe votues nga jashtë sepse ka votues që kanë ardhur nga jashtë dhe kanë votuar më kusht, pra ju edhe atë krahasim e bëni. Prandaj edhe pritet që të përfundojnë ky proces i verifikimit të votave nga jashtë dhe pastaj të krahasohet ato dy lista, kjo pra është arsyeja që jemi duke pritur me na than.

Alim Rama: Mendoj që të dytë e keni gabim këtu, na i kemi aprovua të dy listat, listat e votuesve jashtë Kosovës edhe brenda Kosovës.

Valdete Daka: A mundet dikush me votua dikush me kusht?

Alim Rama: Po sigurisht, po ai krahasohet me listën e votuesve në Kosovë. Lista e votuesve jashtë Kosovës është e aprovuar ndaras edhe aty janë diku 104 mijë edhe kjo është d.m.th nuk kanë nevojë me u prit sepse krahasimi bëhet me listën e votuesve në Kosovë edhe jashtë Kosovës.

Valdete Daka: Dikush që është jashtë që është i regjistrua në listën jashtë Kosovës.

Alim Rama: Unë kam keqkuptua në këshillin për operacione zgjedhore edhe e kuptoj mirë procesin zgjedhor. Këto arsyetime janë të pa baza , unë vetëm deshta me e pyet Burimin , ti kthehemi asaj në këtë listën për rekomandimeve, a ka me u bo verifikime të tjera të brendshme në sistemin në QNR. Janë disa vendvotime që ka pas bartje që të kamë sinjalizua por nuk janë këtu sepse ka pas lëshime në bartjen e të dhënave edhe ato i ke pas me dokumente që janë sinjalizua por që nuk janë në listë. Unë

vetëm I mora disa si shembull kështu që mundet me pas këtu ende. D.m.th rasti kur nuk është bë bartja në faqen e parë nga FRK-ja sepse janë bë lëshimet, besoj që ato janë. Po në anën tjetër sa I përket shpejtësisë, na mundemi me u kënaq që procesi është duke shkuar shpejt por unë vetëm një statistikë e kisha përdor. Na e kemi 130 operator atje në qoftë se secili së paku një formular ose një vendvotim I kish procesu në orë 2050 ishin kry për një ditë, 2050 vendvotime, kështu që na kish mbete shumë pak për ditën e dytë, por na jemi shumë larg. Sa I përket votave me kusht, lista përfundimtare e votuesve është procesua edhe është kompletua 100%. Ato e kemi marr raportin dje kështu që nuk ka kurrfarë arsye me prit për votat me kusht. U përmend disa herë procedura të brendshme por mua nuk më kujtohet që kemi votua procedurat e brendshme të QNR-së edhe nuk janë në ëeb-faqen e KQZ-së. Çfarëdo qofshin ato procedura, ato nuk janë publike edhe nuk janë votuar nga kjo përbërje e KQZ-së në çoftë se janë votuar nga përbërja e kaluar ato nuk janë të qasura në ëeb-faqen e KQZ-së kështu që ekzistojnë një mungesë transparence. Referoju ëeb-faqes edhe mundesh me I gjete. I shikova detajisht po ato nuk janë, procedurat që përmenden këtu as nuk janë publike as nuk janë trajtuar. Edhe rregulla zgjedhore është shumë e shkurtë, nuk I përcakton procedurat në QNR. Kështu që kërkesa ka qenë që i përmendi kolegu Kurteshi që të publikohet lista e të gjithë atyre që kanë aplikuar, një kërkesë e tillë me javë të tëra nuk po implementimet, se kjo kërkesë ka qenë edhe ma herët. Janë 3824 persona që KQZ-ja po I konstaton që nuk kanë aplikuar fare, deri sa nuk është një listë e të gjithë atyre që kanë aplikuar ose të refuzuar. Na veq I kemi do të dhëna parçiale , janë 151 mijë imella që janë dërguar në KQZ-së. Ajo është e dhënë që e kemi është faktike. Pas procesit zgjedhor u bë përditësimi dhe korrigjimi I disa të dhënave prej tyre s'di sa qindra ose me vendime të PZAP janë kthi në listën e votuesve jashtë Kosovës. D.m.th. ka disa të tjerë sigurisht që janë në këtë listë e na nuk e kemi atë raportin. Është shumë domethënëse që raporti të bëhet një për një për secilin që ka votuar të përfshihet po ashtu afatet. Shumë është me rëndësi që tek këta që janë të refuzuar me u kontrollua a kanë përdorë mjetet juridike për me e apelua vendimin e KQZ-së që nuk janë në listë edhe afatet nuk janë respektuar, ato e dinë secili prej neve dhe e ka pas diskutim të gjatë për këtë punë. Na mundemi me vazhdua mos me respektua të drejtën e votës por e drejta e votës I takon secilit qytetar edhe në fund efikasiteti në QNR është larg prej asaj. Veç sa për një shembull, të premtën në mbrëmje ose të premtën në mbrëmje në bazë të statistikave janë mbi 200 persona prezent atje. Kur e pyeta detajisht kush janë ata tha 130 operator edhe 60 kanë qenë në menaxhment. I bjen raporti është një menaxher për dy operator kështu që ajo feltë shumë për efikasitetin e QNR-së.

Artan Asllani: E kam një shqetësim që I përcillet për formularat të përputhjes të rezultateve prej kandidatëve të cilët janë kanë kandidatë për deputet dhe votat të cilat I kanë marr ato vota në qendra të votimit në zonat e caktuara në formularë nuk janë përfshi votat edhe si të tilla janë eliminua. Unë po I shoh, po mundohem me e bë një krahasim të vendvotimet të cilat do të rinumërohen por që në

fakte janë të bazuara ato si dhe mbase vetë kandidatëve për deputet edhe nuk janë numër I paktë. Nuk janë të përfshimë këto qendra dhe mendojë që jem ka flasim për votën e detyrimisht me fajin e secilit do qoftë, mas pak faji ka kandidati për deputet që I mohohet. Në fakt, në formularë nuk I dalin votat të cilat I ka në kuti. D.m.th përderisa numërohen 494 kuti edhe me pas rinumërim të kutive tjera në mënyrë që të barazohet rezultati se ka shqetësim, shqetësim që përcillet edhe nuk e kanë mundësin vetë që drejtpërsëdrejti me e bo këtë shqetësim por I përcjellin format që janë mundësit. Sa kemi mund I kemi përcjell edhe ne deri te veni deri sa ka edhe aso propozime me shku në rinumërim të gjitha kutive. Du me u ndal edhe në temën e dytë te minoritetet, sepse KQZ-ja është organizatore e zgjedhjeve edhe në këtë raste konsideroj se nuk mund të rrim indiferent para asaj se cka ka ndodh edhe në parim po edhe moralisht I përkrahi në të drejtën e secilit komunitet edhe jam kundër formës që të bëhet. Nëse unë mundem me e bo edhe kam mundësi ta bëjë se kjo mundësi është shfrytëzua, është edhe shumë e vërtet që ende pa u shpall zgjedhjet ose hala pa e pas datën e saktë të zgjedhjeve ne e kemi pas paralajmërim edhe kemi pas indikacione se cka ndodhë në teren dhe mendoj që të gjitha organet relevante të cilat janë në Kosovë duhet ta marrin shumë seriozisht këtë si temë edhe të mbrohet e drejta edhe të mbrohet parimi për secilin komunitet. Dhe secili komunitet duhet ta ketë përfaqësimin e vetë pa asnjë presion dhe kjo nuk duhet heshtet po përkundrazi duhet te jetë teme, e cila duhet të diskutohet në çdo nivel.

Burim Ahmetaj: Po ndërlihdna me formularë të rezultateve, sigurishtë që qendra e numërimit dhe të rezultateve do të bëjë edhe kontrollat e tjera duke I kontrollu edhe një herë pothuajse shumicën e formularëve që I bjen në krahasimin mes votave të subjekteve dhe votave të kandidatëve. Do të shohim vizualisht, nëse mund të shohim diku ku përmes sistemit nuk kemi mundur me pa se mund të ketë subjekti vota kandidatë skan apo e kundërta sepse raporti I cili është dërguar në KQZ-ve I referohet të dhënave në bazë të sistemit. Dhe ndoshta vizualisht janë disa vendvotime kur nuk mund të shohim, po sidoqoftë I kemi edhe mekanizmat tjera të kontrollit edhe do ti kontrollojmë të gjitha të dhënat në mënyrë që ti kemi rezultatet e sakta. Sigurishtë që pas procesit të rinumërimit do të bëhet edhe kontrollimi I numrit të nënshkrimeve në listën përfundimtare të votuesve dhe në nënshkrimet e formularëve të përputhjes të dhënave dhe rezultateve sepse edhe ky kontroll na duhet në mënyrë që ti kemi të saktë votuesit dhe alokimin e votave për secilin subjekt dhe për secilin kandidatë. Për këtë është shumë e nevojshme me bë kontrollat dhe do ta shfrytëzojmë kohën gjatë këtyre rinumërimeve ti bëjmë kontrollat. Ndërsa në vendvotime ku sistemi nuk ka deduktua që një vendvotim mund të ketë probleme me votat të kandidatëve sigurishtë që ndoshta ish kanë mirë që kandidatët vet ta shfrytëzojnë të drejtën ti drejtohen PZAP-it sepse KQZ-ja përmes sistemit nuk mundet me gjetë një vendvotim se mund të ketë probleme ose jo. Mipro të gjitha këto vendvotime të cilat janë në rekomandim për tu rinumëruar, rezulton se nuk janë shënuar saktë votat e kandidatëve dhe ky është

problem i cili po na përcjell me vite të tëra. Shpresojmë që të rregullohet ky proces, mirëpo me vite të tëra kemi po thuajse të njëjtën kategori, të njëjtat nivele të mos shënimit të saktë të votave të kandidatëve. Sa i për ketë punës së qendrës së votimit dhe rezultateve për neve është më e rëndësishme saktësia se sa shpejtësia. Kështu që kërkojmë mirëkuptim nga KQZ-ja që ti kemi rezultatet e sakta por jo të shpejta.

Në rezultatet e shpejta, i kemi mekanizmat qysh i publikojnë rezultatet, i kemi rezultate preliminare përmes ueb-faqes apo K-vote. Pastaj jemi në përfundim të procesit të publikimit të gjithë formularëve të rezultateve në ueb-faqen e KQZ-ve ku të gjithë kandidatët do ti mund ti shohin votat e tyre të cilat janë krijuar në vendvotim. Sigurisht vendvotimet të cilat do të rinumërohen, do të privohen rezultatet e reja dhe për këtë do të jetë proces i monitorushëm dhe i vëzhgueshëm nga të gjitha subjektet politike në mënyrë që votat të shkojnë tek kandidati, në të cilit votuesi ka votuar. Ndërkaq sa i përket procedurave të qendrës së numërimit dhe rezultateve në parim nuk ka ndryshuar kurgjo, këto janë miratuar me vite, shumë vite më përpara dhe procedurat e qendrës së numërimit dhe rezultateve ndoshta nuk do të mund të jenë në ueb-faqen e KQZ-së, mirëpo në qendrën e numërimit janë në 3 versione të publikuara, janë fizikisht aty dhe secili vëzhgues ose secili palë i interesuar mund ti marr procedurat e qendrës së numërimit dhe rezultateve të cilat nuk kanë ndryshuar në parim pothuajse asgjë. Pra, është miratua para shumë vitesh, nuk mundem me ditë vitin e saktë po kurgjo nuk ka ndryshua në procedure. Mirëpo ajo se çka është me rëndësi për krejt KQZ-ve dhe për sekretariatit që është shumë esenciale është saktësia dhe për këtë jemi duke punuar kështu që ndoshta afati është shumë më i nevojshëm për subjektet tjera mirëpo për neve është më e rëndësishme saktësia e të dhënave dhe rezultateve. Ndërkaq sa i përket kontrolleve tek votuesit e rregullt dhe votuesit me kusht, dhe votuesit me nevoja të veçanta dhe votuesit me postë gjithmonë kemi bërë kontrollin e këtyre kategorive kur janë verifikuar dhe nuk mund të fillohet procesi i numërimit të votave me kusht, pa u bërë kontrollimi përmes votuesve të rregullt dhe votuesve me kusht. Mirëpo një element është shumë i rëndësishëm se asnjë votues nuk është hequr prej listës së votuesve, votuesi ose është në listën e votuesve jashtë vendit ose është në listën e votuesve Brenda vendit. Në të njëjtën kohë nuk është në të dy listat, ose është jashtë vendit ose është Brenda vendit.

Artan Asllani: Me ju kthye temës së raportit të auditimit për rinumërim të pakove. Realisht unë kom prit që ka me pas më shumë vendvotime që kanë me u rinumërua e sidomos në ato vende ku ka marr vota komuniteti romë. E ceku ma herët zotëri Samiu dhe Ibrahimimi për çështjen shqetësuese sidomos për komunitetin Ashkali tu e ditë që vazhdimisht në të gjitha legjistratuarat përveq zgjedhjes së 2019-tës edhe zgjedhjet e 2021-tës komuniteti Ashkali vazhdimisht i ka pas 2 ulse në parlament. Për arsye të njëjta të zgjedhjeve të 2019-tës edhe të zgjedhjeve të 2021-tës komuniteti Ashkali penalizohet edhe ju hubmet mundësia e një ulëses në parlament. Edhe kësaj here ndodh, unë e kam ngrit këtë çështje

edhe ma herët kur janë regjistruar patrit. Janë kanë të regjistrueme 4 parti politike edhe un vazhdimisht kam thanë që është e pa mundur 4 parti të Romve me i mbledh nga 1000 nënshkrime, bëjnë 4000 nënshkrime tu e ditë përbërjen e komunitetit, tu e ditë se qysh jetojnë edhe sa kanë drejtë vote ai komunitet. E dimë që komunitetet për njoftimin e audiencës është shumë me rëndësi, ekzistojnë 3 komunitete, është komuniteti Romë, komuniteti Ashkali edhe komuniteti Egjiptas. Komuniteti Ashkali është me përbërje nëse i këqyrim statistikat e përbërjes së popullsisë në Kosovë është komuniteti i 4-të më përbërje, me numrin e popullsisë ma të madhe edhe vazhdimisht i ka pas dy ulëse. Kështu që unë apeloj të qendra e numërimit me këqyr edhe njëherë, edhe pse na e dimë që KQZ-ja. Detyrë e KQZ-së me këqyr veq a është votë e vlefshme por, unë bëjnë thirrje të gjitha partitë politike të komunitetit pakicë të shfrytëzojnë të gjitha mundësit e ankesës, të ankohen në PZAP dhe të vazhdojnë edhe më tej në qoftëse edhe në gjykatën kushtetuese me ankesa për këtë çështje. Pjesa tjetër që është, e kam ngrit çështjen edhe te kryeshefi. I shiqova me kujdes të gjitha vendvotimet që kanë me u numëru. Unë kom rekomandu edhe për disa janë disa gabime në Malishevë, në Shtërrpc, edhe nëpër disa komuna tjera ku ka vota që ka gabim, nuk ka përputhje të partive formularë për partitë politike me kandidatë edhe me K-votë d.m.th kanë diferencë. Deshta me bë një pyetje për kryeshefin. A kanë gjetë në ato vende auditori a ka gjetë diçka apo është gjithçka në rregull?

Burim Ahmetaj: Raporti i auditimit bazohet në të dhënat të cilat figurojnë në formularët të rezultateve qoftë për subjekte politike, qoftë të formularëve të rezultateve të kandidatëve. Ato të cilat nuk kanë mundur të kalojnë auditimin për shkak të parregullsive që i cekum ma herët d.m.th subjekti nuk ka pas vota, kandidatët kanë vota apo e kundërta. Dhe kandidati apo të gjithë kandidatët kanë pas ma shumë vota sesa subjekti të gjitha këto i ka dedektu. Mirëpo problemet tjera që i bjen për 80% të vendvotimeve nuk kanë mundur në bazë të të dhënëve, sepse ne gjithmonë bazohemi në ato të dhënat që janë të shkrueme në protokolle, në formularë të rezultateve dhe përmes sistemit nuk janë dedektu deri më tani, problemet të natyrave të tjera. Mirpo siq e thashë edhe ma herët, prap se prapë do të bëjme kontrollet deri te ato që do të mund të shifen vizualisht, që mund të kenë probleme përmes sistemit nuk mund të dedektohen sigurisht që do të sjellim edhe rekomandime të tjera në KQZ-ve. Pra, nuk do të thotë që të gjitha rinumërimet kanë përfundu me sot sepse neve do të na duhet me bo kontrolle të mëtutjeshme të rezultateve qoftë për subjekte, qoftë për kandidatë. Mirpo është qështje që do të na duhet kohë por sido që të jetë do ta shfrytëzojmë kohën e rinumërimit për me i bo kontrollet tjera të formularëve dhe është me rëndësi e thash edhe ma herët është saktësia për ata edhe jemi duke punuar.

Valdete Daka: I kemi rekomandimet në qoftë se mundemi me dal te rekomandimet, më në fund. Po urdhëro Sami!

Sami Kurteshi: Unë dëgjova për saktësinë, për listat e votuesve, publikimin. Sa i përket këtyre gjërave unë po them fakte edhe ato i gjejmë me emra, e me numër personal. Qytetari i Republikës së Kosovës që ka aplikuar për votim nga jashtë, nuk gjendet. As në listën e votuesve jashtë, as në listën e votuesve në Kosovë. Edhe kjo është shkelje flagrante e drejtës politike për të votuar. Qytetari i Republikës së Kosovës që ka numër personal, ka dokument të Republikës së Kosovës, sepse ne d.m.th po luajmë me ato lista, është lista e votuesve jashtë, është lista e aplikuesve që është dashtë me u publiku. Lista e të refuzuarve që është dashtë me u publiku, lista e atyre së paku. Ne e kemi të rregulluar raportin, raportin unë e kam marr po nxirren jo me kusht, jo pa kusht. Po të gjitha listat duhet të publikohen. A është gabimi të ARC-ja të listat që i ka dërgua ARC-ja, a është gabimi të lista që i ka përpunuar KQZ-ja apo është gabimi dikun tjetër nuk është me rëndësi. Veç një merreni me mend Republika e Kosovës shteti I Kosovës ia mohon qytetarit që ka shtetësi të Kosovës, qenit ndonjërin nga listat për votim. Edhe kjo është çështja që mua më brengos më shumë, ai është qytetar i Republikës së Kosovës me drejt vote, të garantuar me kushtetutë pa ndonjë dënim nga ndonjë gjykatë në Republikën e Kosovës që është marr e drejta e votës. Ai ka shkuar në PZAP, PZAP i ka thanë jo s'ke fakte. Unë vec po e ngriti një çështje që për mua është shumë shqetësuese edhe prapë po ju them aj nuk është votues i Lëvizjes Vetëvendosje.

Valdete Daka: Listën votuese nuk e krijojnë na, e marrim nga Agjensioni për regjistrim civil. Na nuk i hjekim as nuk i shtojmë në listë na askënd nuk guxojmë me i hjek prej listës, as me shtu në listë, përveç me vendim të gjykatës. Si vjen lista nga ARC-ja nu nuk mundemi me dhanë përgjegjësi, në qoftëse ai qytetar nuk është në listën e ARC-së nuk është faji i KQZ-së sepse ne nuk mundemi edhe me dashtë, na nuk mundemi me shtu. Edhe me ardh ai me kërkua me u shtu në listë votuese, na nuk mundemi. Le ta kuptojnë të gjithë se na nuk mundemi përpos nëse e ka vendimin e plotfuqishëm të gjykatës e cila na urdhëron me shti në listë votuese. Edhe një her po e përsëris, na listën votuese e marrim nga ARC-ja edhe nuk guxojmë as me hjek, as me shtu askënd në atë listë. Kur se kemi bë, as nuk mundemi me bo edhe me dashtë. Kështu që ai duhet të drejtohet në ARC, ta shikon pse nuk gjendet në listën e ARC-së sepse në qoftë se ka dokument të cilin ia ka lëshuar Kosova, ai është patjetër në atë listë. është e pamundur me pas një dokument të Kosovës e mos me qenë në atë listë. Në ARC duhet me qenë.

Sami Hamiti: Ka raste të tilla të cilat i kanë mbushë moshën mbi 18 vjet, jo 18 po kanë hjek dorë prej shtetësisë, i ka mbete dokumenti. Kemi pas raste që ka ardh të dielën këtu edhe e kom gjete. Ka ardh me trusni të madhe me hi në listë votuese, personi i caktuar kishte hjek dorë prej shtetësisë. I ka hap dokumenti edhe dojke me hi në listë votuese ka edhe raste të tilla. Por nuk dë me thanë kjo që e tha Zotëri Kurteshi sepse ai duhet me kërkua listën votuese se bëjnë se dikush ose në ARC ose dikun sepse nuk është gabimi në KQZ se si bëjmë listat votuese në KQZ.

Alim Rama: Sa zarfe janë pranua ose janë në postat e shpejta, ose në postën e Kosovës. Tash na kemi dëgjua informata që janë disa qindra po ato si janë dedikuar për KQZ-në edhe a i ka pranua KQZ-ja a nuk i ka pranua KQZ-ja ende.

Burim Ahmetaj: Faktikisht sekretariati nuk ka ndonjë procedurë apo vendim prej Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ti pranojë ato zarfe. Mirëpo pavarësisht kësaj sekretariati nga DHL i ka pranua një kontingjente më datën 19 nëse nuk gaboj, i ka pranua edhe për kundër imellave, edhe komunikimeve dhe një far forme presionit nga DHL që ti pranojmë ose ti refuzojmë, megjithatë sekretariati i ka pranuar nga DHL, ndërsa nga postat e tjera po ashtu kemi kërkesa që ti pranojmë dhe jemi në proces e sipër dhe sigurisht do të veprojmë njëjtë sikur që kemi vepru edhe me DHL. Mirëpo e kemi pas afatit, nuk kemi pas ndonjë procedurë ose ndonjë vendim të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve për ti pranuar, po ashtu kemi qenë të zënë me proces dhe jemi këtu po sidoqoftë jemi në komunikim dhe do të veprojmë njëjtë sikurse me postën DHL.

Alim Rama: Më duket është një paqartësi këtu. Na nuk jemi tu fol që ato të fillojnë me u rinumërua meniher, por me u konstatua fakti sa kanë ardh dhe kur kanë ardh. Edhe ato janë të adresuara për KQZ-në kështu që janë në pronësi të KQZ-së. Çka bëhet më tutje me to, është procesi tjetër kështu që numri i saktë edhe kur përafërsisht ato pranohen në KQZ, raportin e saktë në qoftë se ka mundësi.

Burim Ahmetaj: Kur ti pranojmë pjesën tjetër atëherë do të ju raportojmë me imell, kështu që jemi në proces e sipër, jemi edhe në komunikim edhe me ta edhe do ti pranojmë. Sigurisht që mbasi ti pranojmë sepse është posta qendrore, janë edhe dy posta të tjera mirëpo ato janë zarfe të cilat janë adresua për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve edhe pse kanë ardh pas afatit.

Valdete Daka: A bënë të vazhdojmë tek rekomandimet se gjithçka folëm, veq për rekomandime nuk folëm. E kemi rekomandimin nga QNR-ja e ajo është që të rinumërohen 35 kuti fillimisht me rinumërim të plotë për shkak të bartjes së votave gabimisht tek formulari i përputhjes së të dhënave tek FPR. Kush është për këtë rekomandim? Faleminderit. Miratohet.

Kush është për që të rinumërohen 6 vendvotime me probleme teknike të cilat në gjendjen si janë nuk mund të procesohen në bazën e të dhënave për shkak që votat janë të pa qarta, të flasim për votat e kandidatëve. Kush është për? Rekomandimi i 3-të është se duhen të rinumërohen 370 vendvotime në të cilat një kandidatë ka më shumë vota se subjekti dhe në raste të caktuara kandidati, si dhe të gjithë kandidatët e një subjekti kanë më shumë vota se vetë subjekti. Kush është për? Faleminderit. Rekomandimi i 4-të është që të rinumërohen 83 vendvotime tek të cilat nuk ka vota tek subjekti ndërsa kandidati ka vota apo anasjelltas. Kush është për? Faleminderit. Miratohet.

4. Aktivitetet e ZRPP-së

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për regjistrim të partisë politike “Pokret za Župu i Dijasporu – ŽUPSKA”

Yll Buleshkaj: Po fillojmë më së pari me përgjigjen ndaj kërkesës apo pyetjes që e parashtroj Z.Elshani. Teknikisht ka përfundua afati për akreditim të vëzhguesve por ne qoftë se KQZ-ja merr vendim ta shtoj këtë numër, mund ta realizojmë. Mund ta bëjmë edhe verifikimin po ashtu nuk ju është shfrytëzuar i gjithë buxheti që është planifikua për prodhim të distinktivë edhe njëjtë në kontratë është duke zgjat deri në Mars, kështu që teknikisht mund ta realizojmë në qoftë se ka ndonjë vullnet për me u rrit ajo fat pa ndonjë problem shtesë. Ta shikojmë sa është interesi e në takimin e radhës të vijmë me rekomandim para jush në qoftë se ndryshon. Është pak ma pak se 30 mijë, vec si krahasim se herën e kaluar i kemi pas 36 mijë po tash i kemi ma pak. Unë gjatë këtyre ditëve, kush është i interesuar takohemi edhe vim me një rekomandim para KQZ-së pastaj a aprovohet apo jo? Po ashtu siç e keni në agjentë kemi pas një aplikim për një iniciativë të partisë politike, që do të përfaqëson komunitetin boshnjak, iniciativa ka ardh. Kjo iniciativë na është dorëzua me 30 dhjetor, i kemi përpunua të dhënat, jemi kanë gati, të gatshëm me marr rekomandim para ju, pastaj u shpallen zgjedhjet përveç sa i ka pas një ankesë e cila na ka marr pak kohë në shqyrtim. Kjo iniciativë e re e ka qendrën në rajonin e Prizrenit ndërsa emri i saj është SERBISHT shkurt “ZHUPSKA”. Të gjitha dokumentet e dhura si dhe pagesat po ashtu nënshkrimet e përkrahësve i ka dorëzua në kohë dhe janë verifikuar bashkë me divizionin për listën votuese ndërsa pagesa është verifiku bashkë me divizionin për financa, pranë sekretariatit d.m.th kjo initiative ka plotësu të gjitha kushtet teknike. Thash po ashtu gjatë procesit kur të dhënat e këtij subjekti politik kanë qenë publike, kemi pranë një ankesë nga një parti tjetër e cila e përfaqëson komunitetin boshnjak ndërsa pretendimet kanë qenë që termi “ZHUPSKA” apo e ZHUPWS është pozherativ, diskriminues, por qarës për komunitetin boshnjak në Kosovë. Ashtu sipas procedurës i është jep e drejta, iniciativë që ti përgjigjet, iniciativa na ka dërgua një shkresë ku e ka dëshmuar që “ZHUPSKA” është terminologji e një zone e caktuar gjeografike, dhe nuk ka të bëjë me asgjë më diçka pozherative për komunitetin boshnjak e aq më pak edhe përpara dhe diskriminues. Njëjtë kemi kontaktua edhe me disa personalitete të komunitetit boshnjak në Kosovë, nuk kemi marr në indikacione që është diçka diskriminuese, apo pozherativ apo përçarëse për më tepër edhe kemi hulumtua edhe në internet mos ka diçka të tillë dhe nuk kemi arrit të gjejmë që ka diçka që është pretenduar dhe kështu e rekomandoj para jush që të regjistrohet kjo parti e re politike e cila e përfaqëson komunitetin boshnjak, e cila do të ishte e 47-ta me radhë në listën e partive të regjistruara. Na e kemi krye edhe verifikimin e nënshkrimeve, nënshkrimet janë verifikua të gjitha ka pas më shumë se sa 200 që është minimumi, kështu që nuk ka bazë ligjore që të refuzohet kërkesa e tillë. Ana politike është anë politike edhe nuk mundemi me u leshu më shumë në atë farë pune.

Valdete Daka: Kush ka dyshime në nënshkrime duhet ti drejtohet prokurorisë dhe të kërkojë që të bëhen analiza grafologjisë dhe të vërtetohen, se a janë nënshkrime të vërteta. Faktikisht na nuk mundemi prej këtu me e vërtetu.

TEKST SERBISHT

5.Për momentin është vetëm kjo, por nuk do të thotë që do të jetë të tjera. Ne si zyrë vetëm i pranojmë aplikacionet, ato që i plotësojnë kushtet ligjore, i rekomandojmë për regjistrim nuk është që mundemi me e zvogëluar. Është shumë e vërtet që komuniteti boshnjak, pas komunitetit shqiptar ka më së shumti parti politike por si duket ka pas hapësirë edhe interes.

Sami Kurteshi: Unë e ngrita një çështje që e diskutuan edhe të tjerët d.m.th sa i përket votave për listat të ndryshme nga komunitetet e ndryshme, në vendvotimet e ndryshme. Ky është një shqetësim, na mundemi edhe mos ta diskutojmë, e diskutojë Z. Selmanaj, mirëpo unë mendoj se ky ka me qenë një shqetësim, edhe një brengë që ka me ndjek KQZ-në edhe në të ardhmen, edhe me një virulencë pak ma të madhe, kjo është çështja e parë. Çështja e dytë që e kërkoja unë thash megjithatë KQZ-ja duhet ta krijojë një komision i cili duhet të merret me verifikimin e të gjitha këtyre postimeve nga jashtë që quhen të refuzuara, kjo është një kërkesë edhe është një rekomandim që do të krijonte transparencë të plotë edhe do ta çlironte çdo procedurë tjetër nga çdo dyshim. Edhe çështja e tretë është që e ngrita unë vendimi i gjykatës për hetime, për votat nga jashtë për të cilën ne nuk u informuam fare edhe një vendim i gjykatës ekziston. Unë nuk di personalisht kurrëgjë, nëse anëtarët e tjerë nuk kanë kërkesa, unë kam kërkesë që ta di cila është çështja që po hetohet në votat nga jashtë.

Valdete Daka: Ta përfundojmë pikën për të cilën ia nisëm, e ajo është rekomandimi i zyrës që të regjistrohet partia e re politike me emrin serbisht, me akronimin "ZHUPSKA" e cila do të jetë në regjistrin e partive politik të regjistruara me numrin 47-të. Pra, kush është për regjistrimin e kësaj partie të re? Faleminderit. Jo vetëm kjo, po të gjitha partitë të cilat i përmbushin kushtet ligjore, na nuk mundemi me i refuzua, gjithsesi gjithkush që ka ndonjë informatë e cila bie ndesh me ligjet tona në fuqi mundet ti drejtohet prokurorisë dhe të bëjë kallëzimin penal apo ti ngrit dyshimet për të cilat janë. U ngritën çështje lidhur me hetimet po prokuroria speciale e Republikës së Kosovës ka bërë një hetim për disa vota nga diaspora dhe përderisa prokuroria speciale nuk del më njoftim, konsideroj që edhe unë nuk mund të dal me një njoftim, se nuk mund të përzihem në hetimet të cilat janë duke u bërë. Momentin që prokuroria speciale e gjene të arsyeshme me dal me njoftua opinionin për këtë hetim, e njofton dhe atëherë të gjithë e dinë, ndërkaq deri atëherë unë nuk kam të drejtën aq më tepër që jam vet gjyqtare të përzihem në hetimet të cilat janë duke u zhvilluar nga prokuroria speciale.

Po Sami është e vërtet që unë kam urdhrin, i cili më është dorëzuar mua dhe prokuroria me pas gjet të arsyeshme ia u kish dorëzua të gjithëve dhe i kish bë publik atë urdhër. Mos harroni se ai urdhër përmban disa shënime personale të disa personave të dyshuar dhe prokuroria speciale nuk ka dashur që ato të bëhen publike, me pas dashtë me i bë publike, i kish shpërnda.

Sami Kurteshi: Unë absolutisht nuk thash që të bëhet publike, natyra e hetimeve mundet me qenë e ndryshme, mundet me pas hetime publike, jo publike, të rrezikshme, të pa rrezikshme. Pyetja ime tash është, ju e keni një shkresë nga gjykatë edhe ju është dorëzua juve personalisht...

Valdete Daka. Unë një pyetje e kam, po dua me u sqarua. A jeni ju titullari i këtij institucioni? Ju jeni titullar, e unë këtë nuk e paskam ditë. Unë vet ju kam dëgjua por edhe ju keni deklaruar, kur është çështja e marrjes së përgjegjëses, jo keni thanë është trup kolegjal, unë s'marr vendime vet unë nuk bëjë asgjë. Ju vetë keni deklarua, kur është çështja të titullari i informatave që do të duhet ti dinin anëtarët e KQZ-së nuk është më trup kolegjal, kjo është çështja...